

VENDIM
Nr.328, datë 22.4.2020

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM,— NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT, TË KATIT PËRDHES, NË OBJEKTIN NR.1, TRE KAT, PJESË TË PRONËS NR.1047, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR.6620 (PU)”, ME VENDNDODHJE NË LAGJEN “30-VJETORI”, BERAT, DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.114, DATË 17.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË KATIT TË PARË E TË KATIT TË DYTË TË OBJEKTIT NR.1, DHE OBJEKTIT NR.2, PJESË TË PRONËS NR.1047, ME EMËRTIM “QENDËR MOBILIZIMI”, ME VENDNDODHJE NË BERAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr.1, tre kat, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr.6620 (PU)”, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për vendosjen dhe zhvillimin e aktivitetit të administratës së Drejorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit, në Berat.

2. Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit në Berat iu ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.


3. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve, për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr.1, tre kat, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr.6620 (PU)”, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, sipas planimetrisë, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.

4. Vendimi nr.114, datë 17.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr.1, dhe objektit nr.2, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim “Qendër Mobilizimi”, me vendndodhje në Berat”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLANIMETRIA E OBJEKTIT Nr1 KATI PERDHE

SIP e Ndertimit = 198 m²

SHKALLA 1:100



REP. SHQIPERISE	DREJTORI	NKOL: ARMIR ÇANI	
MIN. MBROJTJES	VIZATOI	Ing. A. MURATI	
I.G.J.U.			
Q. R. M.	PERPILOI	Ing. A. MURATI	
BERAT			
DATA 30/11/2011	KONTROLLOI	Ing. K. HYSENI	